



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AKREDITIMIT

PËR SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE KAMËZ

QERSHOR 2026

I. BAZA LIGJORE

Procesi i Akreditimit për ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, mbështetet në Ligjin Nr. 15-2017 datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në Urdhrin nr. 845, datë 3.7.2025 për miratimin e “Rregullores për Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional” të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe në urdhrin e brendshëm të AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 “Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”.

II. KONTEKSTI I OFRUESIT

Histori e shkollës:

Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, ndodhet në Kamëz pranë qendrës sportive kombëtare të futbollit. Institucioni ka filluar si një degë brenda gjimnazit “Ibrahim Rugova”, e cila u ndërtua si shkollë profesionale e pavarur në shtator 2005 dhe u vendos pranë bazës prodhuese të saj.

Viti shkollor 2001-2002 përkon me regjistrimin e vitit të parë të kësaj mature me 35 nxënës ku 12 ishin femra. Në vitin shkollor 2005-2006 në shkollë funksiononin krahas kualifikimeve Teknike mekanike tre-vjeçare dhe kualifikimi Agrobiznes me kohëzgjatje pesë vite. Në këtë vit doli edhe matura e parë me 28 nxënës nga të cilët 11 ishin femra. Në vitet në vazhdim u ofruan edhe kualifikime profesionale të tjera të cilat ofrohen edhe sot. Numri i nxënësve aktualisht është mbi 1500 nxënës, duke e bërë një nga shkollat profesionale më të madhe në vend. Sot, staf i përbëhet nga mbi 110 mësime dhënë, që ofrojnë mësim cilësor në bashkëpunim me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, ofron aktualisht këto kualifikime profesionale sipas KSHK-së:

1. “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, Niveli II në KSHK; T-II-25
2. “Multimedia”, Niveli IV në KSHK; T5-IV-21
3. “Rrjete të dhënash”, Niveli IV në KSHK; T1-IV-21
4. “Zhvillim website”, Niveli IV në KSHK; T3-IV-21
5. “Shërbime mjeteve transporti”, Niveli II në KSHK; M-II-25
6. “Shërbime elektro-auto”, Niveli III në KSHK; M3-III-22
7. “Shërbime motorri”, Niveli III në KSHK; M1-III-22
8. “Shërbime elektro-auto” (Arsim i dyfishtë), Niveli III në KSHK; M3-III-22
9. “Shërbime mjeteve transporti”, Niveli IV në KSHK; M-IV-23
10. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli II në KSHK; G-II-22
11. “Kuzhinë” (Arsim i dyfishtë), Niveli III në KSHK, G8-III-24
12. “Kuzhinë” – Pasticëri”, Niveli III në KSHK; G2-III-22
13. “Shërbime në hotel dhe restorant”, Niveli III në KSHK; G5-III-24

14. “Hoteleri-Turizëm”, Niveli IV në KSHK; G-IV-25
15. “Bujqësi”, Niveli II në KSHK; H-II-22
16. “Agroturizëm”, Niveli IV në KSHK; H8-IV-25
17. “Bujqësi”, Niveli IV në KSHK; H-IV-25
18. “Agrobiznes”, Niveli IV në KSHK, H/I-IV-22
19. “Elektroteknikë”, Niveli II në KSHK; E-II-21
20. “Instalime dhe mirëmbajtje e linjave të tensionit të ulët, të mesëm dhe tensionit të lartë”, Niveli III në KSHK; E2-III-21
21. “Elektroteknikë”, Niveli IV në KSHK; E-IV-25
22. “Shërbime Sociale dhe Shëndetësore”, Niveli II në KSHK; O-II-22
23. “Shërbime kujdesi për fëmijë”, Niveli III në KSHK; O2-III-24
24. “Shërbime kujdesi për të moshuar”, Niveli III në KSHK; O1-III-24
25. “Shërbime Sociale dhe Shëndetësore”, Niveli IV në KSHK; O-IV-25
26. “Shërbime kujdesi për të moshuar” (Pilot GIZ) Niveli IV në KSHK; O1-III-24
27. “Rrjete të dhënash” (Pilot GIZ), Niveli IV në KSHK; T1-IV-21
28. “Menaxhim i strukturave akomoduese”, Niveli V në KSHK; G1-V-24
29. “Teknologji automatizimi”, Niveli IV në KSHK; E5-IV-24

III. PËRMBLEDHJA E PROCESIT

Ofruesi Publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, depozitoi kërkesën për akreditim pranë AKAFPK-së me nr. 417 prot. datë 24.07.2025 “Kërkesë për Akreditim”, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 274 prot., më datë 30.07.2025. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të Urdhrit nr. 845/2025 të MEKI nisi procesin e Akreditimit duke ngritur dhe konsoliduar grupin e vlerësuesve të jashtëm (GVJ), përmes një procedure të miratuar më parë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit, të Shkollës së Mesme Profesionale Kamëz, me qëllim sigurimin e një analize të plotë dhe të saktë ka përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme, si më poshtë:

Metodat dhe teknikat kryesore për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave janë:

- Studim dhe shqyrtim i dokumentacionit institucional.
- Shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të jashtëm
- Vëzhgimi i orëve mësimore
- Vëzhgimi i mjediseve të shkollës dhe të biznesit
- Vizita në bizneset partnere të shkollës
- Intervista
- Intervistë e strukturuar (me drejtorin, sekretaren, kryetarin e bordit, kryetaren e këshillit të prindërve)
- Biseda

- Intervista të pastrukturuara (me instruktorët në biznese)
- Pyetësor në *google form* me grupe të ndryshme interesi
- Analiza e dokumentacionit të vëna në dispozicion nga shkolla.

IV. GJETJET PËR 5 FUSHAT E CILËSISË

Fusha 1 Menaxhimi.

Bazuar në analizën e dokumentacionit të Fushës 1 (Menaxhimi), rezulton se burimet njerëzore, financiare dhe infrastrukturore menaxhohen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në funksion të objektivave të planit afatmesëm dhe planit vjetor. Planifikimi buxhetor miratohet nga Bordi Drejtues dhe mbështetet në regjistrat e prokurimeve, PBA dhe pasqyrat financiare, duke garantuar transparencë dhe gjurmueshmëri. Burimet njerëzore menaxhohen përmes procedurave të dokumentuara të rekrutimit, përshkrimeve të punës dhe vlerësimit periodik të performancës. Zhvillimi profesional planifikohet mbi bazën e analizës së nevojave dhe reflektohet në planet individuale dhe plantet e departamenteve. Sistemet SMIP dhe MesoVet.al sigurojnë menaxhimin efektiv të të dhënave. Pikat e forta lidhen me dokumentimin e plotë, strukturat funksionale dhe përfshirjen e grupeve të interesit, ndërsa pikat e dobëta adresohen përmes planit të përmirësimit të cilësisë, veçanërisht në drejtim të transparencës së publikimit dhe forcimit të zhvillimit të brendshëm profesional. Në tërësi, përdorimi i burimeve mbështet arritjen e rezultateve të pritshme institucionale.

Fusha 2 Marrëdhënia dhe bashkëpunimi.

Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz shfrytëzon në mënyrë efektive mundësitë që krijohen nga partneritetet kombëtare dhe ndërkombëtare për të rritur cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ofrimit të AFP-së. Pjesëmarrja në projektin “Capacity Building Western Balkans” dhe bashkëpunimi me Ammattiopisto Luovi në kuadër të programit Erasmus+ kanë forcuar shkëmbimin e praktikave të mira dhe dimensionin ndërkombëtar të shkollës. Angazhimi në iniciativa si EU4YOUTH, në bashkëpunim me UNICEF Albania dhe UNDP Albania, ka kontribuar në parandalimin e braktisjes shkollore përmes paralajmërimit të hershëm të nxënësve. Mobilitetet e nxënësve dhe projektet evropiane rrisin kompetencat profesionale dhe imazhin institucional. Ndërkohë, promovimet e vazhdueshme në shkollat 9-vjeçare dhe pjesëmarrja në aktivitete komunitare sigurojnë rritjen e regjistrimeve dhe forcimin e lidhjes me komunitetin. Në këtë mënyrë, shkolla shmang rreziqet e izolimit institucional, rënies së interesit dhe performancës, duke garantuar zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Fusha 3 Kurrikula e zbatuar.

Të gjitha kualifikimet profesionale për të cilat institucioni ofrues i AFP-së kërkon akreditim, bazohen tek standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale si dhe në

kurrikulën e miratuar nga AKAFPK-ja. Këto dokumenta mbështeten në strategjinë e hartuar nga Njësia e Zhvillimit, drejtoria e institucionit ofrues të AFP-së dhe Bordit të shkollës. Mësimdhënësit e kulturës profesionale i hartojnë planet mësimore të lëndëve të teorisë profesionale dhe moduleve sipas çdo programi (plani lëndor) dhe udhëzimit të AKAFPK-së. Për lëndët e kulturës së përgjithshme drejtoria zbaton me korrektesi të gjitha procedurat për përzgjedhjen e teksteve mësimore sipas udhëzimeve përkatëse që janë në fuqi. Drejtoria e shkollës planifikon dhe garanton të gjitha burimet e nevojshme për mësimdhënien dhe nxënien, duke e mbështetur zbatimin e planeve mësimore të mësueve me materiale mësimore, tekste, materiale të tjera ndihmëse për mësimdhënien dhe të nxënit. Procesi i mësimdhënies garanton zhvillimin e kompetencave profesionale, kompetencave kyçe, kompetencave digjitale i cili zhvillohet në mjediset/ambientet e shkollës dhe të bizneseve partnere me shkollën.

Fusha 4 Mësimdhënia dhe të nxënit.

Procesi i mësimdhënies dhe i nxënies në Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz bazohet në standardet e profesioneve, standardet e kualifikimeve profesionale dhe skeletkurrikulat e miratuara nga AKAFPK. Gjatë vizitës në terren dhe vëzhgimit të orëve mësimore si në lëndët e kulturës së përgjithshme dhe në lëndët e kulturës profesionale, rezultatet e të nxënit ishin të planifikuara nga mësimdhënësit për njësitë mësimore të cilat i përkasin kompetencave kyçe (aftësitë e shkrimit, leximit, aftësit numerike dhe digjitale) dhe kompetencave profesionale (njohuri, shprehi, dhe qëndrime). Mësimdhënësit përdorin metoda të larmishme dhe përgjithësisht mbajnë parasysht gjëndjen e klasës dhe veçoritë e lëndës. Procesi i mësimdhënies dhe nxënies (metodat, teknikat strategjitë) duke përfshirë detyra shtëpie, detyra klase, teste, projekte, punë në grup, garantojnë arrijtjen e rezultateve të planifikuara të të nxënit dhe në disa raste edhe qëndrimet. Integrimi ndërlëndor përgjithësisht vihet re shumë pak gjatë zhvillimit të orëve. Procesi i mësimdhënies dhe nxënies garanton zhvillimin e kompetencave kyçe edhe për nxënësit me aftësi ndryshe/aftësi të kufizuar të cilët mbështeten nga mësuesi ndihmës. Gjithashtu nxënësit me aftësi të kufizuar kanë akses në ambientet e shkollës sipas projektimit universal. Cilësia e mjedisit ku zhvillohet procesi i mësimdhënies dhe i nxënies të klasave, laboratorëve, kabineteve dhe bizneseve, është i sigurt dhe garanton rezultate të kënaqshme në mësimdhënie dhe nxënie. Nxënësit dhe mësimdhënësit zbatojnë rregullat dhe procedurat e sigurisë gjatë veprimtarive mësimore. Sistemet dhe procedurat e sigurisë, sigurisë në punë, shëndetit dhe parandalimit të funksionojnë sipas legjislacionit. Gjithashtu shkolla ofron edhe shërbime për këshillimin dhe orientimin në karrierë të nxënësve.

Fusha 5 Vlerësimi.

Bazuar në dokumentacionin e Fushës 5, rezultatet reale të të nxënit në Shkollën e Mesme Profesionale Kamëz evidentohen përmes notave të vlerësimit të vazhduar, provimeve përfundimtare të teorisë dhe praktikës profesionale, si dhe performancës së nxënësve në praktikën në biznes. Këto rezultate pasqyrohen në sistemin SMIP, në procesverbalet e provimeve, në listat e kontrollit dhe në analizat vjetore të institucionit. Matja e tyre realizohet përmes instrumenteve të strukturuar të vlerësimit, testeve të integruara, provimeve me komision dhe formularëve të

vlerësimit të praktikës profesionale. Përfshirja e bizneseve në vlerësimin e praktikës garanton objektivitet dhe lidhje me kërkesat e tregut të punës. Treguesit e kalueshmërisë, përqindja nxënësve që përfundojnë kualifikimin profesional si dhe mesatarja e rezultateve analizohen periodikisht nga drejtoria dhe departamentet përkatëse. Dokumentacioni dëshmon se rezultatet janë të matshme, të dokumentuara dhe të verifikueshme, në përputhje me standardet e kualifikimeve profesionale dhe nivelet e KSHK-së.

V. REKOMANDIMET E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

FUSHA 1 MENAXHIMI:

Rekomandimi 1: (kriter bazë 1.1.1.1)

Shkolla të dokumentojë qartë dhe të standardizojë procesin e zgjedhjes së përfaqësuesve të organizmave zyrtare, duke përfshirë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 2: (kriter bazë 1.4.1.4)

Të publikohet i përmbledhur në rrjete sociale të shkollës për të gjitha grupet e interesit raporti i vetëvlerësimit duke filluar nga ky vit shkollor e në vijim.

Rekomandimi 3: (kriteri bazë 1.5.1.2)

Drejtoria e shkollës të sigurojë rekrutimin e mësimdhënësve të kulturës profesionale për vitin shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 4: (kriter bazë 1.5.2.1)

Në planin buxhetor të ardhshëm të parashikohen edhe shpenzimet edhe për trajnime për stafin duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 5: (kriter bazë 1.5.2.1 dhe kriter plotësues 1.5.2.2)

Drejtoria e shkollës të planifikojë në mënyrë të strukturuar stafin drejtues dhe stafin mbështetës në programin e zhvillimit profesional dhe të sigurojë gjithashtu dokumentimin e rezultateve të pjesëmarrjes së tyre në trajnimet përkatëse, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 6: (kriter bazë 1.5.2.4)

Planet individuale të zhvillimit profesional të mësimeve të përfshijnë edhe veprimtari/aktivitete të planifikuara nga organizmat e tjerë në shkollë (departamentet mësimore) duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 7: (kriter bazë 1.6.3.4 dhe 2.2.2.1 dhe kriter plotësues i papërmbyshur 4.1.2.3)

Drejtoria e shkollës duhet të marrë masa për të gjitha kualifikimet profesionale, që të vihen në funksion mjediset e reja dhe baza materiale e nevojshme për realizimin e moduleve të praktikës profesionale, sipas standardeve të profesionit dhe standardeve të kualifikimeve profesionale, në përputhje me përshkruesit e niveleve të KSHK-së, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 8: (kriter bazë 1.6.3.7)

Gjatë vitit shkollor 2026-2027 e në vijim të merren masa për pasurimin e bibliotekës fizike dhe digjitale me libra profesionale, literaturë artistike, shkencore dhe edukative, për zhvillim personal si dhe për shtimin e numrit të anëtarëve të bibliotekës (nxënës dhe mësimeve).

Rekomandimi 9: (kriter bazë 1.6.5.2)

Brenda vitit shkollor 2026-2027 drejtoria e ofruesit të AFP-së të dokumentojë njohjen e stafit mësimor dhe mbështetës me rregullat e sigurisë në mjediset e shkollës.

Rekomandimi 10: (Kriter bazë 1.6.5.4)

Gjatë vitit shkollor 2026-2027 të dokumentohet trajnimi i nxënësve, stafit mësimor dhe mbështetës për rregullat e sjelljes në situata emergjente sipas legjislacionit në fuqi.

Rekomandimi 11: (kriter bazë 1.7.1.1)

Të vendosen në ambientet e shkollës kuti për mundësi ankese nga palët e interesit duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 12: (Kriter bazë 1.7.1.2)

Drejtoria e shkollës duhet të marrë në konsideratë që të përmendet shprehimisht, në çdo vendim të marrë, procedurat dhe afatet kohore të ankimimit duke qenë e qartë për të gjitha palët e interesit, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim.

FUSHA 2 MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI

Rekomandimi 13: (Kriter plotësues 2.4.1.3)

Brenda vitit shkollor 2026 – 2027, shkolla të hartojë dhe zbatojë një plan bashkëpunimi me biznese dhe ofrues të AFP-së (duke i përfshirë ata në rishikimin e programeve mësimore, në përdorimin e përbashkët të mjediseve praktike dhe në zhvillimin e aktiviteteve për zhvillimin profesional të stafit) duke dokumentuar rezultatet e bashkëpunimit.

FUSHA 3 KURRIKULA E ZBATUAR

Rekomandim 14: (kriter bazë 3.1.1.2)

Nga shtatori 2026 e në vijim të merren masa që çdo plan mësimor i mësimdhënies së teorisë profesionale dhe moduleve të firmoset dhe të vuloset nga drejtoria para se të vihet në zbatim.

Rekomandimi 15: (kriter plotësues i papërmbushur 3.1.4.2)

Shkolla të sigurojë që planet ditore për të gjitha kualifikimet profesionale, të përmbajnë edhe objektiva dhe aktivitete konkrete për zhvillimin e kompetencave kyçe (aftësitë e leximit dhe shkrimit, numerike, komunikuese dhe digjitale) duke filluar nga viti 2026-2027 e në vijim.

Rekomandimi 16: (kriter bazë 3.2.1.1)

Për vitin shkollor 2026-2027 drejtoria e ofruesit të AFP-së të marrë masa për shtimin e materialeve mbështetëse mësimore dhe pajisje të tjera ndihmëse për të gjitha kualifikimet profesionale, (në hard-copy ose elektronik).

Rekomandimi 17: (kriter plotësues 3.2.1.2)

Brenda vitit shkollor 2026-2027, drejtoria e shkollës të hartojë dhe zbatojë një plan konkret masash për sigurimin e aksesit të plotë dhe të barabartë të të gjithë mësimdhënësve në pajisjet TIK gjatë procesit mësimor, duke garantuar që çdo kabinet dhe klasë të jetë e pajisur me mjete kompjuterike.

FUSHA 4 MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Rekomandimi 18: (kriter plotësues i papërmbushur 4.1.2.3)

Shkolla të shtojë pajisjet, mjetet dhe makineritë për të realizuar në mënyrë sa më efektive praktikat profesionale për të gjitha kualifikimet profesionale kryesisht për kualifikimin profesional Bujqësi, Agroturizëm, Shërbime Mjetesh Transporti dhe Kuzhinë (Dual), Niveli III i KSHK-së, për vitin shkollor 2026-2027.

Rekomandimi 19: (kriter plotësues 4.2.1.2)

Të përmirësohen planet ditore të kualifikimeve profesionale nga mësimdhënësit duke përcaktuar edhe rezultatet e të nxënit në fushën sociale dhe emocionale për vitin shkollor 2026-2027.

Rekomandimi 20: (kriter plotësues 4.2.1.3)

Për vitin shkollor 2026-2027 e në vijim, shkolla të sigurojë që mësimdhënësit të integrojnë rezultatet ndërkurrikulare të të nxënit në planet mësimore dhe planet ditore.

Rekomandimi 21: (Kriter plotësues 4.3.1.2)

Brenda vitit shkollor 2026–2027, shkolla të sigurojë që të gjithë mësimdhënësit të planifikojnë dhe zbatojnë në mënyrë të dokumentuar metoda të larmishme mësimdhënieje, duke integruar teknologjitë mësimore dhe format e mësimi të kombinuar (blended learning).

Rekomandimi 22: (kriter plotësues 4.3.1.3 dhe 4.3.1.4)

Nga shtatori 2026 e në vijim mësimdhënësit të përdorin më shumë metoda dhe instrumente mësimore që nxisin aktivizimin dhe bashkëpunimin e nxënësve për të mundësuar zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale.

Rekomandimi 23: (kriter bazë 4.3.2.1)

Nga viti shkollor 2026-2027 e në vijim shkolla të mundësojë shtimin e pajisjeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për të realizuar në mënyrë sa më efektive procesin mësimor.

Rekomandimi 24: (kriter plotësues i papërmbyshur 4.3.2.2)

Brenda vitit shkollor 2026–2027, çdo mësimdhënësi të hartojë ose përshtasë materiale mësimore ndihmëse (përfshirë edhe në formatin digjital) për çdo lëndë/modul.

Rekomandimi 25: (kriter plotësues i papërmbyshur 4.4.1.1)

Brenda vitit shkollor 2026–2027, të gjithë mësimdhënësit të rishikojnë dhe të dokumentojnë objektivat dhe strategjitë mësimore bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe feedback-un e nxënësve dhe punëdhënësve, duke zbatuar një format standard reflektimi dhe duke monitoruar zbatimin e tij.

Rekomandimi 26: (kriter plotësues i papërmbyshur 4.4.1.2)

Brenda vitit shkollor 2026–2027 çdo mësimdhënësi të hartojë dhe zbatojë veprimtari mbështetëse përmirësuese për çdo klasë në çdo semestër, të bazuara në analizën e rezultateve të vlerësimit, duke identifikuar nxënësit më vështirësi në të nxënë dhe duke e dokumentuar këtë proces.

FUSHA 5 VLERËSIMI

Rekomandimi 27: (kriter bazë 5.1.1.1)

Nga viti shkollor 2026–2027 e në vijim, mësimdhënësit të planifikojnë dhe të zbatojnë metodologji dhe instrumente të larmishme vlerësimi, duke siguruar vlerësim të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës, të përshtatur me stilet e ndryshme të të nxëniet të nxënësve.

Rekomandimi 28: (kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.1)

Në vitin e ardhshëm shkollor 2026-2027 të intensifikohet bashkëpunimi me bizneset për hartimin e metodologjive dhe të instrumenteve të vlerësimit duke i dokumentuar takimet.

VI. VENDIMI PËR AKREDITIM

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mori vendimin për **akreditim** për ofruesin publik të AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz me Vendim nr. 250, datë 22.06.2026.

AKAFPK ka lëshuar certifikatën e akreditimit, me nr. serie 32, data 26.06.2026 me afat vlefshmërie deri më 21.06.2030.